

**AKT THEMELIMI**  
***Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar***  
***“A.K TRAVEL ”SH.P.K.***

Sot, më datën 04.07.2024, **Z.ARMANDO PASHA** i lindur në Shkoder, Shqiperi më datë 21 Janar 1984, mbajtës i leternjoftimit me numër personal I40121084B, banues në Shkoder, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, vendosi të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **“A.K TRAVEL ”** Sh. P. K. si më poshtë vijon:

**Neni 1**

Personi fizik i sipërpërmendur, me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijon shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh.P.K.) me emërtimin **“A.K TRAVEL” shpk.**

Ortake i kësaj shoqërie është **Z. ARMANDO PASHA.**

Administratore i kësaj shoqërie caktohet **Z. ARMANDO PASHA** shtetase shqiptar, lindur ne Shqiperi me 21 Janar 1984, i pajisur me NID nr. I40121084B. Z.ARMANDO PASHA emerohet administratore i shoqerise per nje periudhe 5 vjecare.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saj brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

**Neni 2**

Shoqëria **“A.K TRAVEL” SH.P.K** gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“Sh.P.K.”**. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë **“A.K TRAVEL ”**SH.P.K. eshte : Rruga Adria, Lagjja 13, nr.3/61+2-N3, ZK 8518

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

**Neni 3**

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe pa afat të përcaktuar.

**Neni 4**

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

- Dhënia ndaj palëve të treta e shërbimeve të konsulencës, asistencës, studimit, ekspertizës, përfaqësimit, ndërmjetësimit, trajnimit, dhe mbrojtjes ligjore, në fushën e zbatimit të Rregullores Evropiane EC261/2004 si dhe Ligjit nr. 96/2020 Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të dalë në zbatim të tij, për të drejtat e pasagjerëve dhe në shtete të tjera në rastet e vonesave, anulimeve dhe mohimit të imbarkimit në fluturime etj.
- Konsulencë, asistencë, ekspertizë, përfaqësim, ndërmjetësim, trajnim, dhe mbrojtje ligjore për sigurimin e kompesimit financiar nga kompanitë ajrore për pasagjerët e ndodhur në rastet e përmendura më lartë, përpara çdo entiteti dhe çdo shkalle të



procese civile, administrative, gjyqësore në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi.

- Në fushën e menaxhimit, ofrimit dhe shitjes së biletave të transportit ajror, detar, tokësor etj. Në fushën e menaxhimit, ofrimit dhe shitjes së paketave individuale dhe të organizuara të paketave turistike, të argëtimit etj.
- Agjensi turistike, transport udhetaresh brenda dhe jashtë vendit, transport udhetaresh nderqytetas, organizim eventesh, shërbime sipas guidave të udhëtimit, transport mallrash.

#### **Neni 5**

Kapitali i shoqërisë është 100.000 Leke. Kapitali i shoqërisë ndahet në një numër kuotaash në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri ku çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri, kuota këto të shlyera si më poshtë:

- **Z. ARMANDO PASHA** zotëruese i një kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 leke që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jete në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme ose të paluajtshme apo të drejta). Ortaket përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundëjt të tremeve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

#### **Neni 6**

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakëve të saj.

#### **Neni 7**

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

#### **Neni 8**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

#### **Neni 9**

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

### **ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

**ARMANDO PASHA**

ARMANDO PASHA